

Sipas informacioneve një avion i ushtrisë së regjimit të Asad ka bombarduar një xhami menjëherë pas namazit të xhumasë në periferi të Damaskut nga ku të paktën 15 persona kanë humbur jetën, raporton Anadolu Agency (AA).

Sipas një deklarate nga Komiteti i Revolucionit Sirian thuhet se një avion luftarak i ushtrisë së regjimit ka sulmuar një xhami në lindje të Damaskut , në një fshat të qytezës së Haresta-s, menjëherë pas faljes së ditës së premte. Nga sulmi të paktën 15 persona pjesë e të cilëve ka fëmijë dhe gra humbën jetën. Sipas informacioneve gjithashtu thuhet se nga sulmi dhjetëra persona kanë mbetur të plagosur disa pre të cilëve janë në gjendje kritike.

Siç dihet në këtë zonë herë - herë përjetojnë përleshje të armatosura mes ushtrisë së regjimit dhe forcave opozitare.